

Termet dhe Kushtet e Përgjithshme të IuteCredit Albania Sh.a.

Në fuqi nga 01.01.2026

1. HYRJE

1.1 IuteCredit Albania Sh.a., me seli të regjistruar në Rrugën “Andon Z. Çajupi”, Pallati Nr. 3, Hyrja Nr. 2, Kati 3, me numër regjistrimi të shoqërisë L42011023U, email: info@iute.al, (në tekstin e mëtejme: Kredithënësi) është një shoqëri financiare e licencuar nga Banka e Shqipërisë.

1.2 Këto Terma dhe Kushte të Përgjithshme (në tekstin e mëtejme: Kushtet), Tarifa dhe parimet e përpunimit të të dhënave të klientit siç përshkruhet në Politikën e Privatësisë, janë pjesë integrale dhe zbatohen për çdo dhe të gjitha marrëveshjet e lidhura ndërmjet Kredithënësit dhe Klientit dhe janë në dispozicion për të gjitha palët e interesuara në ambientet e biznesit të Kredithënësit dhe në faqen e internetit të Kredithënësit.

1.3 Në rastet kur ndryshon kushtet e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve financiare, IuteCredit Albania njofton: a) në mënyrë individuale, secilin klient që është subjekt i këtyre ndryshimeve, sipas afatit dhe formës së përcaktuar në kontratën ndërmjet palëve (me shkrim, nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit ose mesazheve telefonike) dhe të dokumentuar nga institucioni; si dhe b) nëpërmjet afishimit të njoftimeve ose broshurave në ambientet e institucionit, në faqen zyrtare të internetit ose me mjetet e komunikimit masiv. Ky njoftim kryhet të paktën 15 ditë përpara se ndryshimet të bëhen të aplikueshme. Në çdo rast, kushtet e kontratës nuk mund të ndryshohen pa u dhënë pëlqimi i klientit sipas përcaktimeve të kontratës.

1.4 Nëse Klienti nuk është dakord me ndryshimin (et) jo kontraktuale, ai ose ajo do të ketë të drejtën të ndërpresë Marrëveshjen (et) duke e njoftuar Kredithënësin me shkrim ose në një mënyrë tjetër të rënë dakord brenda periudhës së përcaktuar në pikën 1.3. dhe duke përmbushur të gjitha detyrimet e tyre që rrjedhin nga Marrëveshja (et).

1.5 Nëse Klienti nuk ushtron të drejtën e tij, siç përcaktohet në pikën 1.4 për të përfunduar marrëveshjen (t), ai do të konsiderohet se i ka pranuar ndryshimet jo kontraktuale dhe me këtë deklaron se nuk ka pretendime të mëvonshme kundër Kredithënësit në lidhje me ndryshimet e Kushteve, Politikës së Privatësisë dhe/ose Tarifave.

1.6 Kushti për njoftimin paraprak të përcaktuar në pikën 1.3. nuk do të zbatohet në rast se ndryshimi bëhet më i favorshëm për Klientin (p.sh. ulja e tarifave) ose nëse shtohen shërbime të reja.

Kushtet dhe të gjitha marrëveshjet e lidhura në bazë të Kushteve do të rregullohen nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.

1.7 Klienti mund të kërkojë në çdo kohë një kopje të Kushteve të zbatueshme në ambientet e biznesit të Kredihënësit ose t'i gjejë ato në faqen e internetit të Kredihënësit në www.iute.al.

2. PËRKUFIZIME

2.1 Komisioni i Angazhimit është një komision i aplikuar nga Kredihënësi dhe përfaqëson kostot që lidhen me miratimin dhe disbursimin e kredisë Komisioni i Angazhimit do të paguhet në ditën e disbursimit të Kredisë sipas Kontratës së Kredisë Specifike në Llogarinë e Parasë Elektronike IutePay të Klientit. Komisioni i Angazhimit do të zbritet nga shuma e kredisë.

2.2 Tarifa shtesë – të gjitha tarifat e tjera për shërbimet që nuk janë të përfshira në Kontratën e Kredisë Specifike ose në Kontratën e Barrës Siguruese që klienti ka kërkuar dhe Kredihënësi ka kryer shërbimet shtesë dhe tarifat e tyre janë të listuara tek Lista e Çmimeve, të aksesueshme në faqen e internetit të Kredihënësit.

2.3 Kontrata – një marrëveshje ligjërishit e detyrueshme ndërmjet palëve ku Kredihënësi ka pranuar të japë dhe Klienti ka pranuar të marrë një kredi konsumatore. Çdo marrëveshje e tillë e tërë përbëhet nga Kushtet e Përgjithshme, Kontrata Bazë, Lista e Çmimeve, Politika e Privatësisë dhe të gjitha marrëveshjet e tjera, mirëkuptimet e ndërsjella dhe të gjitha anekset e çdo marrëveshjeje të lidhur midis Kredihënësit dhe Klientit (duke përfshirë çdo ndryshim dhe shtesë) si dhe çdo Kontratë Kredie Specifike individuale.

2.4 Plani i Amortizimit – një marrëveshje ligjërishit e detyrueshme që përmban të dhëna për këstet e kredisë së pagueshme dhe maturimin e tyre dhe kushtet që lidhen me pagesën e këtyre shumave, një pasqyrë e çdo pagese me të dhëna për shumën e principalit të kredisë, interesin e llogaritur në bazë të normës së interesit, tarifat dhe kostot shtesë.

2.5 Ligjet e aplikueshme – Aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë të tilla si: Rregullorja nr.48 “Për Kredinë Konsumatore dhe Hipotekore”, Rregullorja nr.59 “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare”, Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile, Ligji për mbrojtjen e konsumatorit, Ligji për dokumentet elektronike dhe nënshkrimet elektronike, si dhe ligje të tjera në fuqi dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë çështje.

2.6 Aplikimi – aplikim për miratimin e një kredie, i dorëzuar në formë të shkruar, elektronike ose verbale nga Klienti te Kredihënësi.

2.7 NEI – kosto totale e kredisë, e cila përfshin interesin, Komisionin e Angazhimit dhe të gjitha llojet e tjera të tarifave, të cilat Klienti është i detyruar të paguajë në lidhje me Kontratën e Kredisë Specifike dhe që janë ose duhet të jenë të njohura për Kredihënësin, duke përfshirë tarifat për shërbimet shtesë të detyrueshme në lidhje

me Kontratën e Kredisë Specifike, dhe në veçanti primet e sigurimit në rastet kur lidhja e kontratës së shërbimit është kusht i detyrueshëm për marrjen e Kredisë, ose në rastet kur dhënia e kredisë është rezultat i aplikimit të termave dhe kushteve tregtare. Kostoja totale e kredisë nuk përfshin tarifat e noterit, tarifat shtetërore apo primet e sigurimit që klienti ka paguar vullnetarisht. Pas llogaritjes së kostos totale të kredisë dhe normës fillestare të përqindjes vjetore, supozohet se kredia është marrë në përdorim pa vonesë dhe plotësisht nga Klienti, Kontrata mbetet në fuqi deri në datën përfundimtare të shlyerjes së shumës së kredisë të rënë dakord në Kontratën e Kredisë Specifike dhe palët do të përmbushin siç duhet detyrimet që dalin nga kontrata. Një shembull i llogaritjes së NEI-së që korrespondon me rregullat e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë të rregullores nr. 59 “Mbi transparencën në shërbimet dhe produktet financiare dhe bankare” parashikohet në Kontratën e Kredisë Specifike.

2.8 Vlerësimi – procesi i vlerësimit të besueshmërisë së klientit, aftësisë për të marrë kredi si dhe vlerësimit të dhe kontrollit të mundësive të klientit për shlyerjen e Kredisë.

2.9 ATM – makineri për tërheqjen e parave në përdorim të IutePay.

2.10 LEK – Monedha Shqiptare. Kreditë e miratuara dhe të disbursuara nga Kredidhënësi në përputhje me Kontratën janë në lekë shqiptar dhe shlyhen nga klienti në lekë shqiptar.

2.11 Ambientet e Biznesit - çdo ambient biznesi, i përdorur nga Kredidhënësi, në të cilin Klienti është në gjendje të kryejë një ose më shumë nga aktivitetet e mëposhtme: të marrë informacion dhe/ose konsultim për kushtet për aplikimin, marrjen dhe përdorimin e një kredie; për të aplikuar për një kredi; për të lidhur kontratën; për të kryer aktivitete të tjera në përputhje me Kushtet ose Kontratën Bazë. Vendndodhja, orari i punës dhe organizimi i përshtatshëm që menaxhon ambientet e biznesit janë të listuara në faqen e internetit të Kredidhënsit.

2.12 Kredi Konsumatore – një kredi që i jepet Klientit, duke përfshirë blerjen e mallrave dhe shërbimeve ose për të rfinansuar detyrimet monetare ekzistuese.

2.13 Rregjistri i Kredive ose RK – Rregjistri i Kredive, i mbajtur nga Banka e Shqipërisë dhe që vepron sipas rregullores përkatëse të Bankës së Shqipërisë.

2.14 Ndërmjetësi i kredisë - një person i autorizuar nga Kredidhënësi për lidhjen e Kontratës në emër të tij.

2.15 Klienti - një person fizik që ka lidhur një marrëdhënie kontraktuale me Kredidhënsin dhe/ose po aplikon për përdorimin e produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga Kredidhënësi.

2.16 Llogaria e Klientit – një llogari e hapur për Klientin bazuar në Kontratën Bazë.

2.17 Llogaria e Parasë Elektronike IutePay të Klientit – llogaria e parasë elektronike të hapur për Klientin nga IutePay, e cila përdoret si një llogari shërbyese për Kredinë sipas Marrëveshjes.

2.18 Numri i referencës së klientit – një numër unik i caktuar për çdo klient, i cili përdoret gjithashtu si numër i Kontratën Bazë.

2.19 Nënshkrimi Elektronik – një nënshkrim i siguar nga Palët duke përdorur një pajisje telefonike të levizshme që është barazvlefshëmme një nënshkrim të shkruar me dorë.

2.20 Tarifat – të gjitha tarifat e ngarkuara nga Kredidhënësi në përputhje me Marrëveshjen.

2.21 Kontrata Bazë – një marrëveshje ligjërishit e detyrueshme ku bien dakord për kushtet për Llogarinë e Klientit, dhënien e Kredive brenda Kufirit të Kredisë Personale dhe shërbimet shtesë të lidhura me Kreditë.

2.22 Interesi – shuma e paguar nga Klienti Kredidhënësit si kompensim për Kreditë.

2.23 Debitim Direkt – është instruksioni i Klientit për IutePay, nëpërmjet të cilit Kredidhënësi autorizohet që të mbledhë këstet nga Llogaria e Pagesës së Klientit kur ato janë berë të pagueshme.

2.24 IutePay – institucioni i parasë elektronike i themeluar në Shqipëri, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombtare e Bisnesit (QKB) me numër unik indentifikimi NUIS M02209002O dhe i licensuar nga Banka e Shqipërisë.

2.25 “Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale” – Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale i ndryshuar kohë pas kohe.

2.26 Kredia – shuma e kredisë konsumatore e miratuar nga Kredidhënësi siç përcaktohet në Kontratën e Kredisë Specifike.

2.27 Numri i Referencës së Kredisë – një numër unik i caktuar për secilën Kontratë Kredie Specifike.

2.28 MyIute – një mjedis online i përdorur së bashku me IutePay i cili u ofron klientëve një mjet për të regjistruar një Llogari Klienti, për të aplikuar për Kredi, për të parë bilancet dhe ngjarjet e tyre të kredisë nën një pamje të kombinuar dhe për të ndihmuar klientët të bëjnë shlyerjet e kredisë pa probleme dhe në kohë.

2.29 Mjet komunikimi i qëndrueshëm - çdo mjet komunikimi që plotëson kriteret e mëposhtme: (i) lejon që informacioni t'i adresohet personalisht marrësit; (ii) i lejon marrësit ruajtjen e informacionit në mënyrë që të përdoret si referencë në të ardhmen dhe gjatë një afati të mjaftueshëm për qëllimin e informacionit, dhe (iii) lejon kopjimin/riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur. Përveç formës me shkrim, Kredidhënësi konsideron si komunikim të qëndrueshëm edhe komunikimin me e-mail, sms, komunikime të regjistruara telefonike etj.

2.30 Palët – siç thuhet në Kontratë ose Kontratën e Barrëve Siguruese.

2.31 Data e Shlyerjes – data në të cilën Klienti është i detyruar të shlyejë kredinë ose çdo lloj detyrimi tjetër, përfshirë të gjitha tarifafat.

2.32 Kontrata e Barrës Siguruese – një kontratë kredie e siguruar me një klauzolë zbatimi.

2.33 Kontratë Kredie Specifike – kontrata e kredisë konsumatore e lidhur për të dhënë një kredi, duke përfshirë blerjen e mallrave dhe shërbimeve ose për të rifinancuar detyrimet monetare tashmë ekzistuese me të gjitha anekset, si dhe Kontratën e Barrës Siguruese me të gjitha anekset.

2.34 Tarifa – lista e çmimeve për shërbimet dhe aktivitetet shtesë të Kredidhënesit të kryera në lidhje me vonesën e klientëve në detyrimet e tyre. Tarifa publikohet në ambientet e biznesit të Kredidhënesit dhe në faqen e internetit.

2.35 Kushtet - këto Kushte që përshkruajnë kushtet e përgjithshme të kredidhënies për individët.

2.36 Website –website i Kredidhënesit, www.iute.al.

3. PARIME TË PËRGJITHSHME PËR HYRJE NË NJË KONTRATË

3.1 Kredidhënesi ka të drejtë të vendosë me kë të lidhë ose të mos lidhë kontratë (liria e kontratës).

3.2 Kredidhënesi mund të miratojë dhe të lidhë një kontratë nëse plotësohen kushtet e mëposhtme;

3.3 Klienti është person fizik dhe shtetas i Republikës së Shqipërisë, të paktën 18 vjeç dhe ka aftësinë juridike për të lidhur një kontratë;

3.4 Identiteti i Klientit verifikohet siç duhet;

3.5 Klienti ka të ardhura dhe mund të përballojë kredinë, ndërsa klientit mund t'i kërkohet të paraqesë dëshmi të dokumentuara për ato të ardhura;

3.6 Klienti ka kërkuar një Kredi nga Kredidhënesi dhe është miratuar;

3.7 Klienti pranon dhe nënshkruan Kontratën Bazë;

3.8 Klienti pranon dhe nënshkruan Kontratën e Kredisë Specifike dhe shtojcat e saj dhe/ose çdo kontratë tjetër që konsiderohet e nevojshme (p.sh. Kontrata e Siguruar etj.);

3.9 Klienti pranon dhe nënshkruan kontraten e llogarisë së parasë elektronike në IutePay;

3.10 Në rast të kontratës së barrës siguruese, kur pengu regjistrohet në Regjistrin e Barrëve Siguruese;

3.11 Miratimi i Kredisë varet nga Vlerësimi. Kredidhënësi gjithashtu mund të miratojë një Kredi bazuar në të dhënat nga baza e të dhënave të brendshme të tij;

3.12 Kredidhënësi nuk do të lidhë Kontrata me shtetas joshqiptarë dhe me klientët që nuk dorëzojnë ose refuzojnë të dorëzojnë të dhënat/dokumentet e kërkuara nga Kredidhënësi për qëllime identifikimi dhe verifikimi dhe/ose për të vlerësuar besueshmërinë dhe përballueshmërinë e tyre kreditore, dhe në përputhje me kërkesat e Kredidhënësit, me kërkesën e Kredidhënësit, nuk ofron të dhëna ose dokumente të mjaftueshme për vërtetimin e ligjshmërisë së fondeve të tyre ose ka arsye të tjera për t'u dyshuar për pastrim parash (përfshirë përdorimin e personit ballor) ose financim terrorizmi.

3.13 Kredidhënësi nuk do të lidhë marrëveshje me Klientët që i kanë shkaktuar dëme të drejtpërdrejta ose të tërthorta Kredidhënësit ose kërcënim për dëmtim aktual ose kanë shkaktuar dëme në reputacionin e Kredidhënësit.

4. DORËZIMI I APLIKIMIT PËR KREDI

4.1 Klienti aplikon personalisht për një Kredi, duke i paraqitur Aplikimin Kredidhënësit. Dorëzimi i Aplikimit mund të bëhet nëpërmjet faqes së internetit të Kredidhënësit, me telefon, aplikacionin celular (MyIute), në ambientet e biznesit të Kredidhënësit ose në një ndërmjetës kredie ose në çdo kanal tjetër të vënë në dispozicion nga Kredidhënësi.

4.2 Për të kërkuar një Kredi nëpërmjet kanaleve digjitale të disponueshme, Klientit do t'i kërkohet t'i japë Kredidhënësit akses në kamerën e telefonit dhe mikrofonin e tij/saj. Klienti duhet ta ketë telefonin të lidhur me internetin dhe të ketë hard-in dhe softuerin e duhur në të dhe telefoni i Klientit mund të ketë nevojë të ketë një lexues të gjurmëve të gishtërinjve dhe/ose aftësi për njohjen e fytyrës.

4.3 Në Aplikim, Klienti deklaron të dhënat e tij personale, emailin, telefonin e kontaktit, etj., si dhe shumën e kërkuar të kredisë dhe afatin e kërkuar të kredisë.

4.4 Kredidhënësi nuk do të jetë përgjegjës për asnjë gabim në të dhënat e paraqitura nga Klienti dhe çdo pasojë nga këto gabime do të përballohet nga Klienti.

4.5 Me paraqitjen e Aplikimit, Klienti duhet t'i japë Kredidhënësit pëlqimin për të marrë një raport nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë (RK). Klienti bie dakord dhe pranon që pëlqimi i dhënë Kredidhënësit për të marrë raporte nga RK do të jetë i zbatueshëm për çdo dhe të gjitha kërkesat që Klienti i ka bërë Kredidhënësit brenda vlefshmërisë së Kontratës Bazë sipas rregullave operative, për mënyrën dhe procedurën , të përdorimit të të dhënave nga RK-së.

4.6 Përpara se Kredidhënësi të pranojë të japë një kredi, Klienti duhet të deklarojë nëse është apo jo një person i ekspozuar politikisht ose i lidhur me një person të ekspozuar politikisht (në tekstin e mëtejshëm: PEP).

4.7 Kredidhënësi rezervon të drejtën që në diskrecion të plotë dhe për qëllime të justifikuara të kërkojë çdo informacion shtesë rreth Klientit për qëllime të zbatimit të Kontratës (p.sh rezidenca tatimore). Klienti pranon t'i japë Kredidhënësit çdo informacion si kërkuar nga Kredidhënësi.

4.8 Para nënshkrimit të Kontratës, Kredidhënësi do të vërë në dispozicion të Klientit të gjithë dokumentacionin parakontraktor për kredinë e kërkuar dhe kushtet e kredisë.

5. IDENTIFIKIMI I KLIENTIT DHE NJIHNI PARIMET E KLIENTIT TUAJ (KYC)

5.1 Klienti, ose në raste të jashtëzakonshme përfaqësuesi i tij, duhet të dorëzojë të dhënat dhe dokumentet e kërkuara nga Kredidhënësi për identifikimin e Klientit.

5.2 Klienti do të identifikohet në bazë të dokumenteve personale të identifikimit që janë në përputhje me legjislacionin dhe të pranuar nga Kredidhënësi (p.sh., një pasaportë, një letërnjoftim).

5.3 Klienti ose përfaqësuesi i tij mund të identifikohet nëpërmjet një mjeti komunikimi të pranuar nga Kredidhënësi ose nëpërmjet mjeteve të identifikimit dixhital.

5.4 Kredidhënësi do të supozojë se dokumentacioni dhe informacioni i paraqitur nga Klienti është autentik, i vlefshëm dhe i saktë.

5.5 Kredidhënësi do të bëjë një kopje të dokumenteve të paraqitura nga Klienti dhe do ta ruajë atë, fizikisht dhe/ose elektronikisht, sipas rregullave të Politikës së Privatësisë.

5.6 Kredidhënësi do të zbatojë masat e vendosura në nivel vendor dhe ndërkombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe evazionit fiskal, si dhe masat e zbatimit të sanksioneve. Prandaj, Kredidhënësi duhet të ketë një pasqyrë të klientëve të tij dhe gjithashtu aktivitetet (p.sh. aktivitetet ekonomike) dhe origjinën e aktiveve të klientëve (duke zbatuar parimin Njih klientin tënd). Bazuar në konsideratat e përmendura, Kredidhënësi ka të drejtën dhe detyrimin që:

5.6.1 të kontrollojë rregullisht informacionin e identifikimit të Klientit ose përfaqësuesit të Klientit dhe të marrë dokumente dhe të dhëna shtesë (duke përfshirë shtetësinë, vendbanimin tatimor, vendbanimin) nga Klienti gjatë gjithë vlefshmërisë së marrëdhënies kontraktuale me Klientin;

5.6.2 rregullisht dhe/ose sipas gjykimit të tij të kërkojë dokumente dhe të dhëna në lidhje me aktivitetet e Klientit, përfshirë të dhëna në lidhje me qëllimin dhe thelbin e transaksioneve dhe origjinën ligjore të aseteve

të Klientit të përdorura në transaksione;

5.6.3 të monitorojë se si Klienti përdor shërbimet e Kredidhënësit dhe rezervon të drejtën të refuzojë të hyjë në marrëveshje të ardhshme me Klientin në rast se zbulohet ndonjë informacion negativ.

5.7 Gjatë zbatimit të masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe masat sanksionuese, Kredidhënësi do të përdorë metoda të bazuara në rrezik dhe do të zgjedhë masën e përshtatshme të masave, nisur nga natyra e transaksioneve, si dhe nga vlerësimi në lidhje me masën e rrezikut që klienti, ose çdo person tjetër i lidhur me transaksionin, mund të angazhohet ose mund të fillojë pastrim parash, financim terrorizmi ose të shkelë sanksionin e vendosur.

6. VLERËSIMI I BESUESHMËRISË DHE TË PËRBALLUESHMËRISË

6.1 Kredidhënësi kryen Vlerësimin e Klientit bazuar në informacionin e disponueshëm, duke përfshirë informacionin e marrë nga Klienti dhe sipas gjykimit të tij, nëse është e nevojshme, pasi bën pyetje në bazat e të dhënave të jashtme që lidhen me vlerësimin e besueshmërisë dhe përballueshmërisë, në të cilat Kredidhënësi ka akses të ligjshëm.

6.2 Klienti është i detyruar t'i sigurojë Kredidhënësit kopjet e dokumenteve të kërkuara për Vlerësimin sipas nevojës nga Kredidhënësi, si p.sh..

6.2.1 një vërtetim punësimi; dhe/ose

6.2.2 një kopje e një raporti bankar; dhe/ose

6.2.3 një dokument për marrjen e pensionit, në rastin e një përfituesi pensioni etj.

6.3 Në rastin e një Aplikimi për Kontratë Barre Siguruese, Klienti është i detyruar t'i sigurojë Kredidhënësit një dokument të vlefshëm pronësie për objektin e pengut për sigurimin e kredisë.

6.4 Si pjesë e Vlerësimit, Kredidhënësi, sipas gjykimit të tij, mund, nëpërmjet punonjësve të tij, të zhvillojë një bisedë me klientin, gjatë së cilës mund të kërkojë dhe të marrë të dhëna ose dokumente shtesë. Të gjitha bisedat e tilla regjistrohen dhe ruhen sipas rregullave të Politikës së Privatësisë dhe do të përbëjnë një pjesë të dosjes së Klientit të mbajtur pranë Kredidhënësit.

6.5 Për qëllime të miratimit të Kredisë, në përputhje me Kushtet, Klienti deklaron se në ditën e kërkesës, ata:

6.5.1 nuk kanë detyrime si garantues dhe as detyrime të pashlyera ndaj shtetit, institucioneve financiare, punëdhënësve aktualë ose të mëparshëm, çdo personi fizik ose juridik ose detyrime për pagesë përpara kredisë për të cilën ata aplikojnë, përveç atyre për të cilat kanë njoftuar Kredidhënësin gjatë procesit të lidhjes së

Kontratës;

6.5.2 ndaj tyre nuk është ngritur asnjë urdhërpagesë nga noteri ose padi dhe nuk dinë ndonjë arsye të arsyetuar objektivisht që mund të çojë në këtë;

6.5.3 nuk është i falimentuar, nuk merr pjesë në marrëveshje, zbatimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me përmbushjen e detyrimeve nga Kontrata;

6.5.4 të gjitha të dhënat e dhëna në Aplikim, janë të plota dhe të sakta.

6.6 Nëse gjatë depozitimit të Aplikimit Klienti jep të dhëna të pasakta, në varësi të momentit të konstatimit të këtij fakti, Kredihënësi rezervon të drejtën ose të refuzojë lidhjen e Kontratës dhe dhënien e Kredisë, ose të ndërpresë Kontratën (nëse e tillë është lidhur) dhe çdo marrëdhënie kontraktuale me Klientin, pa njoftim paraprak dhe të kërkojë shlyerjen e parakohshme të kredisë, së bashku me të gjitha tarifat, kostot dhe interesin e përlllogaritur ose të tilla që do të grumbullohen deri në datën e përfundimit të Kontratës. Kredia deklarohet për pagesë të parakohshme me një deklaratë të njëanshme të Kredihënësit, e cila mund të dërgohet nëpërmjet numrit të telefonit (me SMS) të specifikuar nga Klienti në Aplikim, personalisht, me adresën e deklaruar ose me e-mail.

6.7 Në rast se Kredihënësi miraton Aplikimin, Klienti do të njoftohet në lidhje me të me e-mail dhe/ose numër telefoni (me SMS ose me telefon), personalisht në ambientet e biznesit ose në ambientet e biznesit të një ndërmjetësi kredie ose në mjedisin MyIute.

6.8 Kredihënësi ka të drejtë t'i ofrojë Klientit kushte për lidhjen e një kontrate të ndryshme nga ato të kërkuara, duke përfshirë një periudhë më të shkurtër shlyerjeje kredie ose një shumë më të ulët kredie. Nëse Klienti pranon ofertën duke nënshkruar Kontratën, Kredihënësi nuk kërkon që Klienti të paraqesë një Aplikim të ri.

6.9 Kredihënësi rezervon të drejtën të refuzojë Aplikimin, duke i dërguar një njoftim me shkrim Klientit, qoftë me e-mail, me SMS në numrin e telefonit të specifikuar, duke e shfaqur atë në mjedisin MyIute.

6.10 Nëse është e aplikueshme, Komisioni i Angazhimit është një komision i aplikuar nga Kredihënësi dhe përfaqëson kostot që lidhen me miratimin dhe disbursimin e kredisë. Nëse Klienti ka paguar Komisionin e Angazhimit dhe po ushtron të drejtën e tij për t'u tërhequr nga Kredia, Klienti do ta kthejë shumën e Kredisë duke zbritur Komisionin e Angazhimit.

7. LIDHJA E KONTRATËS

7.1. Çdo Kontratë konsiderohet e lidhur dhe hyn në fuqi pas ekzekutimit të saj nga Palët dhe do të qëndrojë në fuqi për një periudhë të pacaktuar deri në përfundimin në përputhje me Kontratën.

7.2. Çdo Kontratë dhe çdo kërkesë mund të nënshkruhet fizikisht në ambientet e biznesit të Kredihënësit ose në ambientet e biznesit të një ndërmjetësi kredie. Nënshkrimi elektronik mund të kryhet në MyIute ose në një mjedis tjetër online. Palët bien dakord dhe pranojnë se të gjitha deklaratat në lidhje me Aplikimin, lidhjen, zbatimin dhe përfundimin e Kontratës, të nënshkruara me një nënshkrim elektronik të thjeshtë ose të avancuar do të jenë të barasvlershme me një nënshkrim të nënshkruar me dorë.

7.3. Për nënshkrimin elektronik në mjedisin MyIute, do të përdoret certifikata elektronike e Klientit e ruajtur në pajisjen (telefonin) e Klientit. Duke shtypur butonin "Nënshkruaj", një aplikacion do të kërkojë biometrike (gjurmë gishtash ose ID të fytyrës) ose nëse kjo është e aktivizuar, atëherë në rastin e një iPhone do të kërkojë PIN-in e telefonit të Klientit. Informacioni biometrik do të përdoret për të marrë një rezultat verifikimi nga ruajtja e sigurt e telefonit (d.m.th., Secure Enclave për iPhone) dhe duke përdorur certifikatën MyIute të ruajtur atje, nënshkrimi për dokumentin PDF do të krijohet dhe do të dërgohet në serverët e Kredihënësit, ku do të shtohet në skedarin PDF. Asnjë informacion biometrik nuk do të dërgohet në serverët e Kredihënësit. Për më tepër, nuk është e mundur të ndryshohet informacioni biometrik nga ai nënshkrim. Nëse biometria nuk është e konfiguruar dhe në rastin e një iPhone nuk është konfiguruar as PIN-i i telefonit, atëherë Kontrata ose kërkesa do të nënshkruhet në mënyrë elektronike, duke përdorur numrin e telefonit të deklaruar të Klientit, ku Kredihënësi do të dërgojë një mesazh unik një herë- kodin e fjalëkalimit (OTP), të cilin Klienti duhet ta fusë brenda 3 minutave në nënfaqen që i shfaqet. Nëse kodi OTP i futur përputhet me atë të dërguar nga Kredihënësi, Kontrata ose kërkesa konsiderohet e nënshkruar.

7.4. Për nënshkrimin elektronik jashtë mjedisit MyIute, Kredihënësi do të dërgojë një lidhje unike në e-mailin e Klientit dhe duke hapur lidhjen një OTP do të dërgohet në numrin e telefonit të deklaruar të Klientit, të cilin Klienti duhet ta fusë brenda 3 minuta në nënfaqen e shfaqur atij. Nëse kodi OTP i futur përputhet me atë të dërguar nga Kredihënësi, Kontrata ose Kërkesa konsiderohet e nënshkruar.

7.5. Kontrata e siguruar konsiderohet e nënshkruar dhe e lidhur që nga momenti kur Klienti nënshkruan personalisht Kontratën dhe anekset e Kontratës dhe do të informohet për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej saj. Kontrata e Siguruar hyn në fuqi pasi Klienti nënshkruan Kontratën me Kredihënësin dhe pengu regjistrohet në Regjistrin Qendror të Pengeve të Republikës së Shqipërisë.

7.6. Çdo shumë e miratuar dhe disbursuar nga Kredihënësi për Klientin konsiderohet si një kredi e miratuar nga Kredihënësi sipas kushteve të Kontratës.

8. DISBURSIMI I KREDISË

8.1. Kredihënësi do t'i disbursojë Klientit kredinë plotësisht eskuzivisht në Llogarinë e Pagesës së Parasë Elektronike IutePay të Klientit. Nëse Klienti ka më shumë se një llogari në IutePay, disbursimi i Kredisë do të bëhet në Llogarinë e Pagesës së Parasë Elektronike IutePay të Klientit të zgjedhur nga ky i fundit.

8.2. Klienti është në dijeni dhe pranon që tërheqja e fondeve nga Llogaria e Pagesës së Parasë Elektronike IutePay mund të jetë subjekt i komisioneve të vendosura nga IutePay.

8.2.1. në rast se Kontrata lidhet nëpërmjet një Ndërmjetësi Kredie me qëllim blerjen e mallrave ose shërbimeve të Ndërmjetësit të Kredisë Kredidhënësi do të disbursojë shumën e Kredisë në Llogarinë e Pagesës së Parasë Elektronike IutePay dhe bazuar në transaksionin e iniciuar shuma e Kredisë transferohet menjëherë në llogarinë e pagesës të Ndërmjetësit të Kredisë ose në rast se Ndërmjetësi i Kredisë nuk ka një llogari pagese në IutePay, shumat e Kredisë do të transferohen në llogarinë e pagesës së Kredidhënësit, i cili do të transferoj shumat e Kredisë në llogarinë bankare të Ndërmjetësit të Kredisë. Kredidhënësi nuk mban përgjegjësi ndaj Klientit në rast të ndonjë problemi teknik me mallin e blerë ose shërbimin e marrë nëpërmjet financimit nga Kredidhënësi, marrëdhënia ndërmjet Ndërmjetësit të Kredisë dhe Klientit është rreptësisht dypalëshe.

8.3. Nëse Klienti i ka dhënë Kredidhënësit informacion material të rremë ose rrethanat që përbëjnë bazën për dhënien e kredisë kanë ndryshuar (përfshirë gjendja financiare e Klientit është përkeqësuar, me paraqitjen e barrëve të sendit të ngarkuar me kolateral, të cilat nuk dihen nga Kredidhënësi), Kredidhënësi ka të drejtë të refuzojë disbursimin e Kredisë ose të një pjese të saj në bazë të Kontratës.

9. INTERESI, KOMISIONET, TARIFA DHE NEI

9.1. Kredidhënësi ka të drejtën për interes dhe/ose tarifa të tjera siç është rënë dakord në Kontratën e Kredisë Specifike.

9.2. Klienti do t'i paguajë Kredidhënësit interes mbi shumën e mbetur të kredisë bazuar në normën e interesit të përcaktuar në Kontratën e Kredisë Specifike brenda afateve dhe shumave të përcaktuara në Planin e Amortizimit. Me nënshkrimin e Kontratës, Klienti pranon që interesi i kredisë do të jetë i zbatueshëm dhe llogaritur që nga momenti i disbursimit të Kredisë sipas Kontratës së Kredisë Specifike përkatëse.

9.3. Interesi llogaritet çdo muaj me metodën e interesit të thjeshtë për shumën e mbetur të kredisë, duke marrë parasysh se viti ka 360 ditë dhe muaji 30 ditë.

9.4. Komisioni i Angazhimit është një komision i aplikuar nga Kredidhënësi dhe përfaqëson kostot që lidhen me miratimin dhe disbursimin e kredisë. Komisioni i Angazhimit është i pagueshëm në momentin e disbursimit të Kredisë dhe do të mbahet nga Shuma e Kredisë.

9.5. Kostoja totale e Kredisë do të jetë të gjitha kostot, duke përfshirë interesin, Komisionin e Angazhimit dhe të gjitha llojet e tjera të tarifave, të cilat Klienti është i detyruar të paguajë në lidhje me Kontratën e Kredisë Specifike dhe të cilat janë ose duhet të jenë të njohura për Kredidhënësin, duke përfshirë tarifën për shërbimet shtesë të detyrueshme në lidhje me Kontratën e Kredisë Specifike, dhe në veçanti primet e sigurimit në rastet kur lidhja e kontratës së shërbimit është kusht i detyrueshëm për marrjen e Kredisë, ose në rastet kur dhënia e kredisë është një rezultat i zbatimit të termave dhe kushteve tregtare. Kostoja totale e Kredisë nuk përfshin tarifën noteriale ose tarifën shtetërore. Norma fillestare e përqindjes vjetore shpreh kostot totale të kredisë për Klientin, aktuale ose të ardhshme, (përfshirë interesin, kostot e tjera direkte ose indirekte, tarifën e komisionit ose tarifën e çdo lloji) që rrjedhin nga përdorimi i kredisë dhe është shprehur si përqindje vjetore e kredisë

(NEI). Llogaritja e normës fillestare të përqindjes vjetore bazohet në termat dhe kushtet e Kontratës së vlefshme në momentin e lidhjes së Kontratës së Kredisë Specifike ose ndryshimit të saj (përfshirë normën e interesit të vlefshme në atë kohë). Pas llogaritjes së kostos totale të kredisë dhe normës fillestare të përqindjes vjetore, supozohet se kredia është marrë në përdorim pa vonesë dhe plotësisht nga Klienti, Kontrata mbetet në fuqi deri në datën përfundimtare të shlyerjes së shumës së Kredisë të rënë dakord në Kontratën e Kredisë Specifike dhe palët do të përmbushin siç duhet detyrimet që dalin nga kontrata. Një shembull i llogaritjes së NEI që korrespondon me rregullat e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë të rregullores nr. 59 “Mbi transparencën në shërbimet dhe produktet financiare dhe bankare” parashikohet në Kontratën e Kredisë Specifike.

9.6. Norma maksimale e përqindjes vjetore e një kredie (NEI maksimale) është kostoja totale maksimale e një kredie e llogaritur si një mesatare e normës efektive të interesit të aplikuar nga Kredidhënësi sipas llojit të kredisë konsumatore, duke marrë në konsideratë/shtuar gjithashtu një të tretën në të sipas dispozitave të rregullores së ndryshuar të Bankës së Shqipërisë “Për kredinë konsumatore dhe hipotekore”. Kjo normë do të përcaktohet nga Banka e Shqipërisë në fund të çdo semestri për semestrin e ardhshëm dhe do të publikohet në faqen zyrtare të internetit.

10. PLANI I AMORTIZIMIT

10.1. Gjatë vlefshmërisë së Kontratës Kredidhënësi do t'i vërë në dispozicion Klientit Planin e Amortizimit pa pagesë.

10.2. Plani i Amortizimit përmban të dhëna për detyrimet mujore të pagueshme të kredisë dhe maturimin e tyre dhe kushtet që lidhen me pagesën e këtyre shumave, një pasqyrë të çdo pagese me të dhëna për shumën e huasë dhe interesin.

10.3. Klienti mund të shikojë Planin e Amortizimit në platformën MyIute, por me kërkesë të Klientit, Kredidhënësi do t'i dorëzojë Klientit Planin e Amortizimit me postë ose e -mail.

10.4. Për lehtësinë e Klientit, Kredidhënësi do të rrumbullakos këstet, të përcaktuara në Planin e Amortizimit, pasi barazimi do të kryhet me detyrimin e fundit të shlyerjes.

11. SHLYERJA E KREDISË

11.1. Klienti do të shlyejë Kredinë sipas termave dhe kushteve të parashikuara këtu dhe në përputhje me shumat e përcaktuara në Planin e Amortizimit.

11.2. Klienti do të shlyejë Kredinë eskuzivisht nëpërmjet Llogarisë së Parasë Elektronike IutePay të Klientit.

11.3. Me nënshkrimin e Marrëveshjes, Klienti është në dijeni dhe shprehimisht i jep të drejtën Kredidhënesit të vijojë me një Debitim Direkt automatik nga Llogaria e Pagesës së Parasë Elektronike IutePay të Klientit për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të bera të pagueshme. Klienti duhet të bëjë të mundur që në Llogarinë e Pagesës së Parasë Elektronike IutePay të Klientit të ketë fonde të mjaftueshme për të realizuar ripagimin e

detyrimeve në kohën e duhur.

11.4. Klienti do të paguajë me shpenzimet e tij të gjitha kostot që mund të shkaktohen në lidhje me zbatimin e Kontratës.

11.5. Klienti pranon se nëse klienti ka më shumë se një Kredi të papaguar ose detyrime të tjera ndaj Kredidhënësit, shlyerja e këtyre pagesave do të bëhet sipas gjykimit të Kredidhënësit.

11.6. Në rast se Klienti ka më shumë se një kredi të papaguar me Kredidhënësin shpërndarja e fondeve të marra nga Klienti do të bëhet midis shumave së pari të detyrimit dhe së dyti në maturim, në rendin e mëposhtëm:

11.6.1. shpenzimet e mbledhjes gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, shpenzimet për letra rikujtuese, dërgimi i mesazheve;

11.6.2. kamatëvonesa të përlllogaritura ose gjoba të vonuara;

11.6.3. tarifaf;

11.6.4. interesi;

11.6.5. Shuma e Kredisë.

11.7. Të gjitha shumat e ripaguara konsiderohen të vlefshme nga momenti që shumat e identifikuar janë berë të disponueshme në Llogarinë e Pagesës së Parasë Elektronike të hapur në IutePay. Nëse Kredimarrësi ka përfituar ndonjë pagesë nga Klienti nëpërmjet kanaleve të tjera përveç Llogarisë së Pagesës IutePay të Klientit, përfituesi i fondeve duhet të jetë i identifikueshëm për të konsideruar fondet si të marra nga Kredidhënësi dhe fondet do të transferohen në Llogarinë e Pagesës së Parasë Elektronike IutePay. Nëse në Llogarinë e Pagesës së Parasë Elektronike IutePay të Klientit ka fonde të pamjaftueshme për ripagimin e detyrimeve të kërkueshme nga Kredidhënësi ndaj Klientit, ky i fundit do të mbajë përgjegjësi për të gjitha pasojat e një pagese në vonesë. Nëse fondet e pranuar nga Klienti nuk janë të mjaftueshme të shlyejnë të gjitha detyrimet e bëra të kërkueshme, shpenzimet e lidhura me detyrimet e pa përmbushura apo të pa përmbushura brenda afatit janë të pagueshme të parat në përputhje me pikat 11.5 dhe 11.6.

12. SHLYERJA E PARAKOHSHME

12.1. Klienti ka të drejtë të shlyejë kredinë plotësisht ose pjesërisht para kohe, nëpërmjet një kërkesë për shlyerje të parakohshme te Kredidhënësi duke përdorur mjete të qëndrueshme të komunikimit, të paktën 3 (tre) ditë para. Për shlyerje të pjesshme të shumës së papaguar të kredisë, ekzekutimi i kërkesës bëhet në datën e këstit të ardhshëm, pavarësisht ditës së kërkesës për shlyerje të pjesshme. Në datën e këstit të ardhshëm, fillimisht paguhet kësti i kredisë sipas planit të pagesave dhe më pas proçesohet me shlyerjen e pjesshme të parakohshme.

12.2. Në rast të shlyerjes së plotë të parakohshme të Kredisë, Klienti duhet të ketë gjendje të disponueshme në llogarinë e tij të pagesës së parasë elektronike pranë IutePay shpk të mjaftueshme për të shlyer shumën e papaguar të kredisë dhe interesat e grumbulluara dhe tarifaf e tjera deri në ditën e shlyerjes së parakohshme.

12.3. Në rast të shlyerjes së plotë të parakohshme të Kredisë Cash, Kredidhënësi ka të drejtën e kompensimit për çdo kosto që lidhet drejtpërdrejt me shlyerjen e parakohshme në masën 1 për qind të Kredisë së parapaguar, kur periudha e mbetur e Kontratës së Kredisë Specifike është më e gjatë se një vit dhe në masën 0.5 për qind të Kredisë së parapaguar kur periudha e mbetur e Kontratës së Kredisë Specifike është më pak se një vit. Klienti nuk detyrohet të kompesojë Kredidhënësin për kostot e shlyerjes së parakohshme të kredisë në rastet kur ka ushtruar të drejtën për t'u tërhequr nga Kontrata e Kredisë Specifike, në përputhje me kerkesat ligjore.

12.4. Klienti do t'i paguajë Kredidhënësit tarifën për shlyerjen e parakohshme në ditën e shlyerjes së parakohshme të Kredisë, nëse shlyerja e parakohshme është e plotë.

12.5. Nëse Klienti ka kërkuar të shlyejë kredinë para kohe dhe nuk e ka shlyer kredinë në shumën e plotë, ose te pjeshme të kredisë, siç kërkohet nga Klienti, brenda afateve të përcaktuara nga Kredidhënësi, do të konsiderohet se Klienti ka hequr dorë nga kërkesa për shlyerje të parakohshme.

12.6. Nëse klienti nuk e ka nënshkruar Planin e ri të Amortizimit të Kredisë, si rrjedhojë e kërkesës për shlyerje të pjeshme të parakohshme, përpara datës së shlyerjes së pjeshme të parakohshme, kërkesa do të anulohet.

12.7. Shlyerja e parakohshme e Kredisë mund të kryhet gjithashtu duke miratuar një Kontratë të re Kredie Specifike për Klientin nga Kredidhënësi ("Kredi Rifinancuese"). Nëpërmjet rifinancimit të kredisë, si fillim bëhet mbyllja e kredisë ekszistuese dhe pjesa e kredisë që mbetet mbas mbylljes, përdoret për qëllime konsumi. Kredidhënësi nuk është i detyruar të miratojë kërkesën për kredi rifinancuese.

Në rast shlyerje para afatit nëpërmjet rifinancimit të kredisë, me një kredi të re konsumatore, klienti do të paguajë komisionin e angazhimit mbi principalin e kredisë së re konsumatore, në ditën e disbursimit të saj.

13. E DREJTA E TËRHEQJES

13.1. Klienti ka të drejtë, pa paguar dëmshpërblim ose gjobë dhe pa dhënë arsye, të tërhiqet nga Kontrata e Kredisë Specifike brenda 14 ditëve nga data e disbursimit të Kredisë sipas Kontratës së Kredisë Specifike ose nga data në të cilën Klienti merr informacionin për të drejtën e tij për t'u tërhequr.

13.2. E drejta e tërheqjes nga Kontrata e Kredisë Specifike do të konsiderohet e ushtruar me kusht që Klienti t'i dërgojë Kredidhënësit një njoftim me mjete të qëndrueshme të komunikimit përpara skadimit të afatit dhe Kredimarësi ka marrë pagesën e plotë të Kredisë sipas pikës 13.3. Nëse Klienti bën shlyerjen e plotë të Kredisë brenda periudhës 14-ditore të tërheqjes dhe nuk e njofton Kredidhënësin për qëllimin e kreditimit të llogarisë, fondet do të tranferohen në Llogarinë e Klientit duke mbetur si balance kreditore në këtë Llogari.

13.3. Në rast se Klienti ushtron të drejtën e tij për t'u tërhequr nga Kontrata e Kredisë Specifike, ai do t'i kthejë Kredidhënësit shumën e kredisë dhe interesin e perllogaritur i cili llogaritet në bazë të ditëve që Kredia ka qenë në përdorim nga Klienti brenda të njëjtit afat prej 14 ditësh, duke zbritur vlerën e paguar të Komisionit të Angazhimit. Interesi llogaritet në bazë të normës së interesit në ditë siç është rënë dakord në Kontratën e

Kredisë Specifike.

13.4. Nëse Klienti nuk ka fonde të mjaftueshme në Llogarinë e Pagesës së Parasë Elektronike IutePay të Klientit, përgjatë periudhës 14 ditore të tërheqjes duke filluar nga disbursimi i Kredise, e cila do të lejojë Kredidhënësin të kërkojë kundrejt Klientit të gjitha detyrimet atëherë do të konsiderohet që klienti nuk është tërhequr nga Kontrata e Kredisë Specifike dhe Kontrata vazhdon vlefshmërinë e saj, sipas kushteve në të cilat është lidhur, duke përfshirë aplikimin e Planit të Amortizimit, një shtojcë e Kontratës së Kredisë Specifike, me të gjitha pasojat e çdo vonese të Klientit.

14. PASOJAT E PAGESËS SË VONË

Nëse Klienti nuk i përmbush plotësisht dhe në kohë detyrimet e tij sipas Kontratës, Kredidhënësi ka të drejtat e mëposhtme:

14.1. Për të llogaritur interesin e vonesës për vonesën e detyrimeve nga data e skadimit të tyre deri në shlyerjen e detyrimeve. Norma e interesit të vonesës llogaritet në përputhje me Kodin Civil dhe në masën e lejuar nga Banka e Shqipërisë. Interesi i aplikueshëm i pagesës së vonuar publikohet në Tarifë. Në datën e lidhjes së kësaj Kontrate Kuadër, interesi i vonesës është 3 % (tre për qind) në ditë e llogaritur mbi shumën e kredisë plus interesin e çdo detyrimi mujor me vonesë duke filluar nga dita pas datës kur detyrimi ka hyrë në afat. Interesat e pagesës së vonë të cilat paguhën nga Klienti, nuk kalojnë në asnjë rast me shumë se 30% të shumës së detyrimit kontraktor (këstit/kësteve të papaguar të kredisë).

14.2. Për të llogaritur dhe paguar një tarifë administrative për njoftimet e detyrimeve të vonuara të dërguara me SMS nga dita e dytë e vonuar dhe tarifë administrative për njoftimet me shkrim të dërguara si më poshtë: paralajmërimi i parë me shkrim, paralajmërimi i dytë me shkrim, paralajmërimi me shkrim para përfundimit të Kontratës dhe njoftimin me shkrim për zgjidhjen e Kontratës, ndërsa kjo e fundit dënohet me ndërprerje. Tarifa (at) do të llogaritet sipas Tarifës së vlefshme në ditën e njoftimit.

14.3. Për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me ligjet në fuqi, duke përfshirë përfundimin e Kontratës dhe çdo Kontrate tjetër të lidhur ndërmjet Palëve dhe për të kryer të gjitha aktivitetet e nevojshme për mbledhjen e kërkesave të saj përpara të gjitha autoriteteve dhe institucioneve kompetente, duke përfshirë por pa u kufizuar në gjykata, noterë, përmbarues dhe të tjerë.

14.4. Për të dorëzuar në Regjistrin e Kredive informacionin mbi detyrimet e Klientit, të cilat mund të ndikojnë në besueshmërinë e klientit në të ardhmen. Të dhënat për Klientin dorëzohen në Regjistrin e Kredive në bazë të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

15. PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

15.1. Kredidhënësit i lind e drejta të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Kontratën Bazë dhe/ose çdo

Kontratë Kredie Specifike në fuqi dhe të kërkojë nga Klienti që të shlyejë menjëherë kredinë (të) e papaguar, interesin (at), komisionin (et), tarifat, kamatëvonesat, penaltetet dhe pretendimet e tjera që rrjedhin nga Kontrata Bazë dhe/ose çdo Kontratë Kredie Specifike brenda 3 (tre) ditëve pune nga marrja e një njoftimi përkatës nga Kredidhënësi nëse:

- 15.1.1. Klienti ka vonesë në pagesën e detyrimeve të tij sipas Kontratës Bazë dhe të paktën në njërën prej Kontratave të Kredive Specifike për më shumë se 90 (nëntëdhjetë) ditë;
- 15.1.2. Klienti i ka dhënë Kredidhënësit informacione të rreme në aplikimin për kredi ose dokumente të tjera të rreme ;
- 15.1.3. Klienti nuk përmbush siç duhet ndonjë nga detyrimet që rrjedhin nga Kontrata;
- 15.1.4. Në rastin e një kredie të siguruar me kolateral, vlera e tregut të sendit në cilësinë e kolateralit zvogëlohet në atë masë sa kjo vlerë të mos jetë e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata, ose sendi objekt kolaterali humbet apo bie në pavlefshmëri dhe Klienti nuk arrin të shtojë kolateral tjetër apo të zëvendësojë kolateralin e mëparshëm me një kolateral të ri, kundrejt pëlqimit të Kredidhënësit. Në rast të ndërprejres së kontratës për arsyet e mësipërme nga ana e Kredidhënësit dhe mosshlyerjes së menjëhershme të detyrimeve nga Klienti brenda 3 (tre) ditëve pune nga marrja e njoftimit nga Kredidhënësi, kredia do të klasifikohet “kredi e humbur” dhe do të raportohet me këtë status në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë;

15.2. Klienti ka të drejtë të përfundoj Kontratën Bazë dhe çdo Kontratë tjetër të Kredisë Specifike në çdo kohë duke i paraqitur Kredidhënësit një njoftim me mjete komunikimi të qëndrueshëm për këtë qëllim, të paktën 3 (tre) ditë përpara përfundimit të synuar. Përfundimi i çdo Kontrate Kredie Specifike do të konsiderohet si një shlyerje e parakohshme siç përshkruhet më sipër dhe mund t'i nënshtrohet një tarife shlyerjeje të parakohshme.

16. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

16.1. Kontrata është një akt për dhënien e kredisë nga institucionet financiare jobanka dhe si e tillë përbën një titull ekzekutiv të detyrueshëm për Klientin.

16.2. Në rast të një konflikti ndërmjet Kontratës Kuadër dhe çdo Kontrate Kredie Specifike, do të zbatohen dispozitat e Kontratës së Kredisë Specifike.

16.3. Klienti është në dijeni dhe pranon se Kredidhënësi ka të drejtë të transferojë dhe/ose caktojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga çdo Kontratë Kredie Specifike, si dhe të lërë peng të arkëtueshmet e kredisë nga Kontrata (t) e Kredisë Specifike te një palë e tretë.

16.4. Klienti nuk mund t'i transferojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kontrata ose ndonjë Kontratë Kredie Specifike te një palë e tretë pa marrë një pëlqim paraprak me shkrim nga Kredidhënësi.

16.5. Palët bien dakord t'i dërgojnë njoftime njëra-tjetrës me mjete të komunikimit të qëndrueshme duke përdorur adresat më të fundit të deklaruara për Palën tjetër. Palët bien dakord të informojnë Palën tjetër për çdo ndryshim material që mund të ketë efekt në Kontratë. Çdo njoftim do të konsiderohet se hyn në fuqi që nga momenti i dorëzimit të tij aktual: (a) me dorëzimin në dorë palës tjetër; (b) me dorëzimin e njoftimit në adresën e emailit/numrin e telefonit të Palës tjetër; (c) ditën e dytë pas dërgimit me shërbim postar të regjistruar ose të certifikuar, (d) ditën e njoftimit në llogarinë individuale "MyIute" në web (e) në ditën e njoftimit në kohë reale në platformën "MyIute", të cilat janë bërë nga Mjetet e Komunikimit të Qëndrueshëm.

16.6. Klienti dhe Kredidhënësi do të përpiqen t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet me pajtim, zgjidhje, ndërmjetësim ose mjete të tjera paqësore, përndryshe do të vendosë gjykata kompetente.

16.7. Kontrata do të rregullohet nga ligjet materiale të Republikës së Shqipërisë. Çdo veprim, padi ose procedim, duke përfshirë çdo masë të përkohshme mbrojtjeje ose lehtësim paraprak, që rrjedh nga ose në lidhje me Kontratën do të ngrihet ekskluzivisht dhe zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

16.8. Asnjë heqje dorë nga ose në emër të Kredidhënësit nga ndonjë prej të drejtave të tij sipas Kontratës nuk do ta lirojë Klientin nga përbushja e plotë e detyrimeve të përcaktuara në Kontratë, me përjashtim të masës kur kjo heqje dorë e qartë është bërë me shkrim nga Kredidhënësi.

16.9. Çdo lehtësim, përbushje ose vonesë nga Kredidhënësi në ushtrimin, ose çdo dështim i Kredidhënësit për të ushtruar, çdo të drejtë sipas Kontratës ose ligjit në fuqi nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë dhe nuk do të ndikojë në aftësinë e Kredidhënësit më pas për ta ushtruar këtë të drejtë ose për të ndjekur ndonjë mjet juridik, derisa kjo të parashkruhet sipas ligjit.

16.10. Nëse ndonjë dispozitë e Kontratës konsiderohet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, tërësisht ose pjesërisht, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të Kontratës nuk do të ndikohen ose dëmtohen në asnjë mënyrë prej saj, dhe dispozita e prekur do të konsiderohet se është zëvendësuar automatikisht nga një dispozitë tjetër e zbatueshme, e vlefshme dhe ligjore që ka të njëjtin efekt ose efekt sa më të ngjashëm të mundshëm, të dispozitës së prekur, ose nëse kjo nuk është e mundur, të qëllimit origjinal të Palëve me hyrjen në Kontratë.

IuteCredit Albania Sh.a.